



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, me 15 qershor 2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica – Xhelili, Mergim Lushtaku, Fidan Jilta, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Floretë Zejnullahu, Agim Veliu, Besnik Tahiri, Igor Simiq.

Në mbledhje morën pjesë: KDI, Ekonomia online dhe Kosovapress.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica -Xhelili, kryetare e komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 01.06.2021;**
- 3. Njoftim për Komisionin nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për dorëheqjen e Kryetarit të Këshillit;**
- 4. Shqyrtimi i shkresës me informata të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil sipas kërkesës së Komisionit;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 01.06.2021;

Procesverbali u miratua me vërejtjen e anëtarit të komisionit, Mergim Lushtaku - lidhur me

kërkesën e komisionit adresuar KPMSHCK-së, kërkoi që në procesverbal nuk është inkorporuar kërkesa e tij si kërkesë specifike që komisionit ti adresohen të gjitha lëndët ashtu si kanë qenë të radhitura për shqyrtim nga KPMSHC, dhe si janë redaktuar ato në kolegje, gjithashtu kërkoi incizimin e mbledhjes në fjalë.

3. Njoftim për Komisionin nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për dorëheqjen e Kryetarit të Këshillit;

Doarsa Kica – Xhelili, njoftoi komisionin lidhur me dorëheqjen e kryetarit të KPMSHCK-së dhe për njoftimin e dorëheqjes të datës 12.06.2021.

4. Shqyrtimi i shkresës me informata të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil sipas kërkesës së Komisionit;

Mergim Lushtaku, u deklarua se nga materiali që KPMSHC i ka ofruar komisionit ka dëshmi dhe informata të mjaftueshme se ndarja e lëndëve është bërë në kolegje brenda këshillit, gjë që dëshmon se këshilli ka ushtruar funksionin në bazë të ligjit dhe nuk ka bazë për ndonjë dyshim për shkelje.

Doarsa Kica – Xhelili, tha se përgjigjet e ofruara nga këshilli nuk janë përgjigje sipas kërkesës së komisionit dhe komisioni ka kërkuar dokumentacion shtesë lidhur me lëndët.

Fitim Haziri, tha se KPMSHCK në mbledhjen kur ka raportuar për punën 1 vjeçare, në atë mbledhje komisioni ka kërkuar informata shtesë lidhur me trajtimin e lëndës së zyrtarit të nivelit drejtues të MTI, ndërsa që nga përgjigjet e ofruara të këshillit nuk kemi vërejtur ndonjë dëshmi që ne do të mund të ishim shmangur nga dyshimet andaj kjo vërteton se ka pasur shkelje të pavarësisë institucionale dhe shkeljen e nenit 12 të ligjit për KPMSHCK-në.

Besim Muzaqi, pyeti si mund të konsiderohet si institucion i pavarur, kur KPMSHCK ka fshehur, anashkaluar vendimin e Gjykatës Supreme, të nëntorit të vitit 2020, i cili nuk ka qenë përmbarues që nënkupton se ai nuk ka mundur të kthehet në vendin e punës.

Besnik Tahiri, tha se me gjithë dorëheqjen këshilli duhet të jetë funksional dhe nuk mund të konkludohet për një çështje, edhe për rastin në fjalë, deri sa të mos dëgjohen dy palët.

Doarsa Kica – Xhelili, pyeti parafolësin, si e vlerësoni punën e një këshilli apo bordi?

Besnik Tahiri, vlerësimi i punës së çdo institucioni përshkruhet në raport vjetor, raporti ka qenë i mirë edhe pse komisioni ka kërkuar një informatë shtesë për një rast të caktuar.

Doarsa Kica – Xhelili, duke i'u drejtuar përsëri parafolësit, tha se, komisioni ka kërkuar informatë shtesë për lëndët që kanë qenë në pritje, ato të protokoluara, datat e lëndëve dhe për të cilat komisioni nuk ka përgjigje, ndërsa që krejt kjo ka qenë arsyeja e takimit.

Agim Veliu, tha se, mënyra e diskutimit është presion në institucionet e pavarura dhe kërkoi kujdes nga komisioni, mendimi i tij ishte se nga këshilli të kërkohet raport për të gjitha lëndët, dhe pastaj të bëhet vlerësimi i performancës.

Pyetja e tij ishte se deri tek dorëheqja e kryetarit të këshillit a ka ndikuar kërkesa e komisionit për informata shtesë, nga takimi i kaluar.

Nijazi Isaku, tha se, kryetari i KPMSHCK-së ka dhënë dorëheqje vetëm nga pozita e kryetarit, çka domethënë se ende mund të jetë anëtar, sepse nuk ka dhënë dorëheqje nga funksioni. Në asnjë vend në raport nuk ka është vërejtur një standard i qëndrueshëm rreth trajtimit të lëndëve dhe nuk është qartësuar arsyeja e vendosjes së lëndëve me prioritet.

Valon Ramadani, tha se në takimin e kaluar është kërkuar info shtesë nga KPMSHCK duke mos i'u limituar kohën e përgjigjes.

Ai e njoftoi komisionin, anëtarët, deputetët e rinjë të komisionit, se anëtarët aktual të KPMSHCK-së gjatë intervistave të tyre pranë komisionit ad hoc, të njëjtit janë zotuar se do ta respektojnë ligjin në tërësi dhe do të jenë të paanshëm në ushtrimin e funksionit, ndërsa që veprimet e tyre dhe praktika kanë dëshmuar se të njëjtit e kanë shkelur nenin 12 të ligjit në fuqi. Gjithashtu, kryetari i këshillit gjatë raportimit në takimin e kaluar është deklaruar se nuk kanë shkel ligjin, se nuk kanë qenë të ndikuar nga qarqet e ndryshme për vendosjen e lëndëve dhe kanë theksuar para komisionit parlamentar se nëse i njëjti komision konfirmon se këshilli ka bërë edhe vetëm një shkelje do të jap dorëheqje, andaj dorëheqja e tij konfirmon se ka shkelur ligjin, dhe ka ofruar dorëheqjen si akt moral të tij.

Ai propozoi, që të iniciohet procedura e shkarkimit të të gjithë anëtarëve të këshillit dhe propozimi i tij të hudhet menjëherë në votim.

Konstatim: Komisioni me 6 vota “Për” dhe 4 vota “kundër”, miratoi propozimin e lartëcekur dhe nxori këtë:

REKOMANDIM

I. I Rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë shkarkimin e 5 (pesë) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

1. Eshref Shabani,
2. Malsore Gashi-Bajraktari,
3. Jeton Koca,
4. Arben Mehmeti dhe
5. Ardita Haxhnikaj- Demi.

II. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet deputetja, Doarsa Kica-Xhelili, kryetare e Komisionit.

Arsyetim

Komisioni, në bazë të nenit 15 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar procedurën për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Rekomandimi për iniciimin për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bëhet sipas nenit 15, paragrafi 1, pika 1 dhe 3, si në vijim:

1.1. për shkelje të dispozitave të ligjit për KPMSHCK-në;

1.3. në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij;

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur me 01.06.2021, ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së KPMSHCK-së, dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e Raportit vjetor të punës së KPMSHCK-së, për vitin 2020.

Në mbledhjen e mbajtur me 15.06.2021, është diskutuar lidhur me shkeljet e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Me këtë rast, është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.

Rrjedhimisht, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2021, me 6 vota “Për” dhe 4 “Kundër”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK-së.

Në bazë të nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit për KPMSHCK-në: “Kuvendi i Kosovës me shumicë të votave mund të shkarkon anëtarin e Këshillit”.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Doarsa Kica Xhelili